# DËSHMI ARKIVI

**A-473150**

VERSIONI 3

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | 88 pako të fshehura në furgon, kapen 91 kilogramë kanabis në Kakavijë, destinacion Greqia! Arrestohen burrë e grua (VIDEO) - Shqiptarja.com |
| ADRESA | `https://shqiptarja.com/lajm/kapen-90-kilograme-kanabis-ne-kakavije-furgoni-kishte-destinacion-greqine-shoqerohen-shoferi-dhe-nje-pasagjer` |
| BURIMI | shqiptarja.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 08:22:10 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 08:17:42 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8fa14f5787fd496d337202d626867f9d3bf68b967471329c821d4eb27d8af376` |
| TEKSTI | `60f96c75e656b04ec7d18e6d3ef2e80eeb8b7d930ec8223ca353e897fe67591b` |
| PAMJA | `9ab55bf3095139c378dc9e0eb1385227ac2f9e11f867452c94669c1f34b0fb90` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `05f15e4fd613d2d34cac7322aec36e5c3c18d127a0edb56bf1d25e3c37a8b889` |
| E MËPARSHMJA | `d9958d05ea0017084b032c65a5e4538705a5f89264c49e7c4fb26cd5e186c875` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/05f15e4fd613d2d34cac7322aec36e5c3c18d127a0edb56bf1d25e3c37a8b889`

### PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1



Ftesa e Ramës, kryetari i GJL Sadushi: Jo tryezë për pagat, çështja në GJK! Mbetemi të hapur për një dialog ndërmjet pushteteve, me qytetarin në qendër

Kronikë

# 88 pako të fshehura në furgon, kapen 91 kilogramë kanabis në Kakavijë, destinacion Greqia! Arrestohen burrë e grua (VIDEO)

*88 pako ishin fshehur në një shtresë të posaçme në dyshemenë e mjetit. Në prangat e 'bluve' të Gjirokastrës kanë përfunduar shoferi dhe e shoqja, Klejdi dhe Bukurije Agalliu. Furgoni i nisur nga Shqipëria është ndaluar nga efektivët shqiptarë dhe sekuestruar bashkë me drogën.*




Redaksia
27 Shtator, 10:16 | **Përditesimi: 27 Shtator, 11:32**

Share Tweet

91 kilogramë kanabis me destinacion Greqinë janë kapur në pikën kufitare të Kakavijës brenda një furgoni. 88 pako ishin fshehur në një shtresë të posaçme në dyshemenë e mjetit.

Në prangat e 'bluve' të Gjirokastrës kanë përfunduar shoferi dhe e shoqja, Klejdi dhe Bukurije Agalliu. Furgoni i nisur nga Shqipëria është ndaluar nga efektivët shqiptarë dhe sekuestruar bashkë me drogën.

Rrethanat e ngjarjes janë nën hetim si dhe po punohet për identifikimin e personave të tjerë të përfshirë.



LEXO EDHE:
**Gjirokastra, qarku 'më i plakur', Kukësi 'më i riu'! Rritet mosha mediane, gratë me diferencë nga burrat**

**Njoftimi i policisë:**

*Falë kontrolleve të shtuara nga Policia Kufitare bazuar në analizën e riskut, parandalohet dhe goditet një rast i tentativës për trafikimin e lëndëve narkotike drejt Greqisë.*

*Gjatë kontrolleve intensive, me përdorimin e mjeteve logjistike bashkëkohore, shërbimet e Policisë gjetën të fshehura në brendësi të një furgoni rreth 88 pako me lëndë narkotike të dyshuar cannabis, me peshë totale rreth 91 kilogramë.*

*Vihet në pranga drejtuesi i furgonit dhe pasagjerja, bashkëshortë me njëri-tjetrin.*

*Shërbimet e Policisë Kufitare, si rezultat i kontrolleve të imtësishme për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e tentativave për trafikimin e lëndëve narkotike, si dhe i intensifikimit të kontrolleve bazuar në analizën e riskut në bashkëpunim me specialistët për Hetimin e Narkotikëve në DVP Gjirokastër, kaluan për kontroll të detajuar në skaner dhe më pas në vijën e dytë, në dalje të RSh-së, furgonin që drejtohej nga shtetasi K. A..*

*Nga kontrolli i imtësishëm, shërbimet e Policisë gjetën të fshehura, në vende të krijuara posaçërisht në dyshemenë e furgonit, poshtë shtresës së saj, rreth 88 pako, brenda të cilave kishte lëndë narkotike të dyshuar cannabis, me peshë totale rreth 91 kilogramë.*

*Në vijim të veprimeve të para hetimore, specialistët për Hetimin e Narkotikëve në DVP Gjirokastër arrestuan në flagrancë shtetasit K. A., 28 vjeç, dhe B. A., 25 vjeçe, të dy banues në Tiranë, bashkëshortë me njëri-tjetrin.*

*Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan rreth 91 kilogramë lëndë narkotike e dyshuar cannabis dhe furgoni.*

*Strukturat e DVP Gjirokastër, në bashkëpunim me DVP-të e tjera, nën drejtimin e Prokurorisë së*

*Gjirokastrës, po vijojnë veprimet hetimore për identifikimin e personave të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale.*

*Materialet procedurale do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për veprime të mëtejshme, për veprën penale "Trafikimi i lëndëve narkotike".*

*Lajm në përditësim...*

-------------------------------

***Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë***

P.J/E.H/Shqiptarja.com

TAG: bukurije agalliu | klejdi agalliu | kanabis | kakavije | Gjirokaster

Sa e vlerësoni këtë artikull?

LAJMET MË TË VLERËSUARA

**Komente**

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**

26 Shtator, 18:15

**Ambasadori i ri i SHBA nis misionin, a besoni se do sjellë ndryshim në mjedisin politik?**

Po | Jo | Disi

## Lajme të tjera



**Dyshohet se kultivoi 143 bimë kanabisi në Vilës të Vaut të Dejës, arrestohet 50-vjeçari (VIDEO)**

24 Shtator, 11:15



**Zjarr në Parkun Natyror të Viroit në Gjirokastër, dyshohet i qëllimshëm**

23 Shtator, 18:33



**Zbulim arkeologjik në Qesarat të Tepelenës! Dalin në dritë gjetje që mund t'i takojnë një qyteze, me mozaikë të shekullit III**



Piro Nase

23 Shtator, 15:34





**Shisnin kanabis pranë shkollave, arrestohen 2 persona në Kuçovë dhe Moravë, sekuestrohen mbi 4 kg drogë (VIDEO)**

23 Shtator, 12:18





**Nën vëzhgim prej 2 muajsh, arrestohet 26-vjeçari në Mamurras! I gjenden 338 doza droge, një pjesë e tyre me THC të lartë (EMRI+VIDEO)**

23 Shtator, 09:21



**Gjirokastër/ Zjarr në Lazarat, flakët përhapen me shpejtësi! Forcat zjarrfikëse në terren për izolimin e vatrës**

22 Shtator, 21:08



**Zjarr në fshatin Jorgucat të Gjirokastrës, flakët u përhapën pas rënies së rrufesë në majë të malit**



**Restaurohet Teqeja e Koshtanit në Memaliaj, ministri Gonxhja: Mbart vlerat e traditës**



**Zjarr pranë fshatit 'Arshi Lengo' të Gjirokastrës, flakët ju afrohen banesave! Një vatër**

22 Shtator, 18:11

kontribut të çmuar për arsimin shqip (FOTOT)

22 Shtator, 17:32

varrezave në Babicë të Vlorës

20 Shtator, 14:57



**Kontrabandë nga Greqia me autobus, arrestohen dy 43-vjeçarë në Gjirokastër! U kapën me 22 mijë euro, 100 steka cigare dhe mallra të fshehura**

20 Shtator, 10:32



**Iu gjetën 400 kilogramë kanabis në frigorifer, arrestohet i riu shqiptar në Itali**

19 Shtator, 20:45



**Polemikat për manekinin e Çerçiz Topullit, jep dorëheqjen kreu i Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore në Gjirokastër**

19 Shtator, 11:53



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.